

**OJQ “iCHAT”**  
**INSTITUTI CILËSOR PËR HULUMTIME, ANALIZA DHE**  
**TRAJNIME**

**RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR**  
**DHE**  
**PASQYRAT FINANCIARE**

**Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2018**

**Bahtijar Berisha, Auditor Ligjor**

**22 Mars 2019**



## PËRMBAJTJA

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR.....	3
PASQYRAT FINANCIARE .....	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE .....	5
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR – BILANCI I GJENDJES .....	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË FONDE .....	7
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË .....	7
SHËNIME SHPJEGUESE DHE POLITIKAT KONTABËL .....	8
1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME .....	8
2. POLITIKAT KONTABËL .....	11
SHËNIME SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE .....	13
<i>Shtojca 1</i> .....	16
<i>Shtojca 2</i> .....	17

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

**Për: Bordin e drejtorëve të OJQ "iCHAT"**

### *Opinion*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të OJQ "iCHAT", të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën **31 Dhjetor 2018**, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve në fonde për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare të OJQ "iCHAT" prezantojnë në mënyrë të drejtë dhe të sinqertë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të OJQ "iCHAT", performancën financiare si dhe rrjedhën e parasë për vitin që përfundon më **31 Dhjetor 2018** në përputhje me bazat e përpilimit të raportimit financiar të përshkruara në paragrafin 2.1 të këtij raporti.

### *Baza për Opinionin*

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### ***Përgjegjësitë e Menaxhmentit***

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet e Raportimit Financiar të zbatueshme në Kosovë, dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpres aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### ***Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare***

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijjë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare. Një përshkrim më i detajuar i përgjegjësisë së audituesit për auditimin e pasqyrave financiare mund të gjendet në *Shtojcën 1* të këtijë raporti. Ky përshkrim përbën pjesë të raportit tonë të auditimit.

Bahtijar Berisha, Auditfor ligjor

22 Mars 2019





## PASQYRAT FINANCIARE

## PASQYRA E TË ARDHURAVE

## OJQ "iCHAT" Instituti Cilësor për Hulumtime, Analiza dhe Trajnime

Pasqyra e të ardhurave  
për periudhën 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2018

Të ardhurat	Shënim	2018 Euro	2017 Euro
Të hyrat nga grantet dhe donacionet		51,124.00	155,667.71
Të hyrat nga aktivitetet		-	-
Të hyrat tjera		-	3,509.09
<b>Gjithsej te ardhurat bruto</b>	<b>6</b>	<b>51,124.00</b>	<b>159,176.80</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Shpenzimet programore	7	154,662.06	27,113.66
Shpenzimet e menxhimit dhe administrates	8	12,539.77	1,005.21
Shpenzimet e tjera (zhvleresimi)	8	211.97	264.96
<b>Gjithsej shpenzimet</b>		<b>167,413.80</b>	<b>28,383.83</b>
<b>Net rritje / pakësim nga operacionet</b>		<b>(116,289.80)</b>	<b>130,792.97</b>
<b>Shpenzimet e tatimit në fitim</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Net rritje / pakësim i fondeve të periudhës</b>		<b>(116,289.80)</b>	<b>130,792.97</b>
Net rritje / pakësim i fondeve nga periudhat e kaluara		132,117.77	1,324.80
Shlyerjet e inventarit dhe korigjimet		-	-
<b>Fondet e mbajtura në fund të vitit</b>		<b>15,827.97</b>	<b>132,117.77</b>

Këto pasqyra financiare janë përgatitur, aprovuar dhe nënshkruar nga menaxhmenti i OJQ-së

Përgatitur nga: Arbnesha Kastrati  
(Emri, mbiemri dhe nënshkrimi)

Datë: 28.02.2019

Aprovuar nga: Besmir Kokollari  
(Emri, mbiemri dhe nënshkrimi)

Datë: 28.02.2019



## PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR – BILANCI I GJENDJES

<b>OJQ "iCHAT" Instituti Cilësor për Hulumtime, Analiza dhe Trajnime</b>			
Pasqyra e pozitës financiare - Bilanci i gjendjes			
për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2018			
<b>PASURITË</b>	<b>Shënim</b>	<b>2018</b>	<b>2017</b>
		<b>Euro</b>	<b>Euro</b>
<b>Pasuritë afatshkurtëra</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	14,980.10	131,057.93
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera		-	-
<b>Gjithsej pasuritë afatshkurtëra</b>		14,980.10	131,057.93
<b>Pasuritë afatgjata</b>			
Prona dhe pajisjet	4	847.87	1,059.84
<b>Gjithsej pasuritë afatgjata</b>		847.87	1,059.84
<b>GJITHSEJ PASURITË</b>		<b>15,827.97</b>	<b>132,117.77</b>
<b>FONDET DHE DETYRIMET</b>			
<b>Detyrimet afatshkorta</b>			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera		-	-
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurta</b>		-	-
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		-	-
<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>		-	-
<b>FONDET</b>			
Net rritje/pakësim të fondeve nga periudhat e kaluara		132,117.77	1,324.80
Net rritje/pakësim të fondeve nga periudha vijuese		(116,289.80)	130,792.97
<b>Gjithsej fondi</b>		<b>15,827.97</b>	<b>132,117.77</b>
<b>GJITHSEJ FONDET DHE DETYRIMET</b>		<b>15,827.97</b>	<b>132,117.77</b>

Këto pasqyra financiare janë përgatitur, aprovuar dhe nënshkruar nga menaxhmenti i OJQ-së

Përgatitur nga: Arbneshja Kastrati  
(Emri, mbiemri dhe nënshkrimi)

Datë: 28.02.2019

Aprovuar nga: Besmir Kokollari  
(Emri, mbiemri dhe nënshkrimi)

Datë: 28.02.2019



## PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË FONDE

<b>OJQ "ICHAT" Instituti Cilësor për Hulumtime, Analiza dhe Trajnime</b>				
Pasqyra e ndryshimeve në fonde				
për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2017				
	<b>Fondet fillestare</b>	<b>Fondet e akumuluar</b>	<b>Rezervat e tjera</b>	<b>Gjithsej</b>
	<b>Euro</b>	<b>Euro</b>	<b>Euro</b>	<b>Euro</b>
<b>Gjendja më 1 Janar 2017</b>	-	<b>1,324.80</b>	-	<b>1,324.80</b>
Net rritje / pakësim nga operacionet		130,792.97		130,792.97
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	-	<b>132,117.77</b>	-	<b>132,117.77</b>
Net rritje / pakësim nga operacionet		(116,289.80)		(116,289.80)
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2018</b>	-	<b>15,827.97</b>	-	<b>15,827.97</b>

## PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

<b>OJQ "ICHAT" Instituti Cilësor për Hulumtime, Analiza dhe Trajnime</b>			
Pasqyra e rrjedhës së keshit (parasë)			
për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2018			
	<b>Shënim</b>	<b>2018</b>	<b>2017</b>
		<b>Euro</b>	<b>Euro</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>			
<b>Fitimi / (humbja) i / e vitit</b>		<b>(116,289.80)</b>	<b>130,792.97</b>
<b>Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave</b>			
Zhvierësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		211.97	264.96
Tatimi në fitim		-	-
		<b>211.97</b>	<b>264.96</b>
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative (Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera		-	(570.93)
		-	<b>(570.93)</b>
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative</b>		<b>(116,077.83)</b>	<b>130,487.00</b>
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese</b>		-	-
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese</b>		-	-
<b>Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë</b>		<b>(116,077.83)</b>	<b>130,487.00</b>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	3	131,057.93	570.93
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>		<b>14,980.10</b>	<b>131,057.93</b>



## SHËNIME SHPJEGUESE DHE POLITIKAT KONTABËL

## 1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

OJQ "Instituti Cilësor për Hulumtime, Analiza dhe Trajnime" - iCHAT është një organizatë jo - qeveritare e themeluar në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës . Ligjit Nr. 04/L-57 neni 18 paragrafi 3.3 Raporti financiar, nga OJQ-të me statusin e përfituesit publik ka kërkesa për raportim të veçantë. OJQ -ja duhet të bëjë një raport vjetor mbi aktivitetet dhe arritjet dhe të paraqes pasqyrat vjetore financiare të përbëra nga bilanci i gjendjes dhe një pasqyrë e të ardhurave.

- Organizata quhet "INSTITUTI CILËSOR PËR H U L U M T I M E , A N A L I Z A D H E T R A J N I M E"
- Ajo njihet edhe si OJQ "iCHAT"
- Organizata është shoqatë jofitimprurëse, sipas definimit të dhënë në nenin 5.2 dhe 6 të Ligjit Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

<b>Data e regjistrimit:</b>	13 Nëntor 2014
<b>NRB:</b>	5115285-9
<b>NRSP:</b>	6001206-7
<b>NRF:</b>	601207659
<b>TVSH:</b>	330322173
<b>Lloji i shoqërisë:</b>	Organizatë Jo Qeveritare
<b>Adresa e regjistrimit:</b>	Rr. "Tringë Smaili" Nr.40/-1, Prishtinë
<b>Themeluesit e OJQ-së:</b>	Zt. Astrit Tafolli, Fsh. Shirokë, Suharekë Zt. Besmir Kokollari, Rr. Tring Smaili, Nr.29, Prishtinë Zt. Alban Sllamniku, Fsh. Miradi e poshtme, Fushë Kosovë
<b>Përfaqësues i OJQ-së:</b>	Zt. Besmir Kokollari, Drejtor Ekzekutiv



## MISIONI, QËLLIMI DHE AKTIVITETE E ORGANIZATËS

### *Misioni i "iCHAT":*

"iCHAT" është organizatë jo qeveritare dhe jofitimprurëse që promovon vlerat demokratike, paqën dhe sigurinë në vend dhe rajon, përmes avokimit në mënyrë që të ngritet niveli i demokracisë, transparencës, llogaridhënies, gjithëpërfshirjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm social dhe ekonomik.

Të ofrojë nxitje dhe veprimtari të vlefshme për krijimin e nismave dhe politikave efektive, ide dhe aksione konkrete për të mundësuar një reagim të integruar të shtetit, shoqërisë civile dhe komunitetit ndaj veprimeve negative dhe të atyre që nxisin për veprime të tilla. Objektivi është që ta adresojmë këtë veprim në mënyrë efektive dhe dinamike në katër fushat bazë të përballimit të problemit, në zbatimin e ligjit, parandalimin, trajtimin e zvogëlimin e dëmit dhe edukimin.

### *Qëllimi i "iCHAT":*

- Hulumtimit dhe analizave të pavarura të politikave publike në lëmin e qeverisjes demokratike si dhe hulumtime dhe analiza të shëndosha profesionale me paanshmëri të plotë të çështjeve vendore, rajonale dhe ndërkombëtare.
- Fuqizimit të rolit të minoriteteve në shoqëri (të drejta të pakicave) – që jetojnë në Kosovë duke i përkrahur, duke i promovuar të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, që të jenë qytetarë të barabartë në Kosovë dhe njëherit duke qenë zë i fuqishëm i tyre për mundësi të barabarta për të gjithë komunitetet që jetojnë në Kosovë.

Për t'i përmbushur qëllimet iCHAT është fokusuar në këto fushëveprimtari: Hulumtime dhe Analiza, konsulenca, fuqizimi i rolit të minoriteteve në shoqëri (të drejtat të pakicave), avokim dhe lobim, të drejta të njeriut, organizimi i kurseve për edukim dhe trajnim, etj.

### *Shtirja e projekteve dhe veprimtaria e "iCHAT" përgjatë vitit 2017-2018:*

OJQ "iCHAT" ka implementuar projektin "Riintegrimi i qëndrueshëm i të rikthyerve dhe parandalimin e migrimit të qytetarëve në Pejë, Skendraj dhe Drenas", i cili mbështetet nga

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH bazuar në kontratën Nr. 81219157 nënshkruar me 16 nëntor, 2017. I cili implementoher nga 1.12.2017 deri më 31.08.2018. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të mbështesë qëndrueshmërinë socio-ekonomike të personave të riathesuar dhe parandalimin e migrimit ilegal për qytetarët në Pejë, Skenderaj dhe Drenas, me fokus në komunitetet minoritare (Boshnjak dhe komuniteti Romë, Ashkali dhe Egjiptas) përmes ngritjes së vetëdijes dhe ngritjes së kapaciteteve për punësim. Pjesa e trajnimeve të projektit është fokusuar në fushat dhe sektorët me potenciale më të larta biznesi dhe mundësi punësimi dhe në këtë mënyrë, aktivitetet e projektit janë dizajnuar që të rezultojnë me rezultate të qëndrueshme.

OJQ "iCHAT", po ashtu mbajti Edicionin e tretë të Konferencës Ndërkombëtare Modeli i Kombeve të Bashkuara. Pavaresisht faktit të hidhur se të rinjt tanë po vazhdojnë të përballen me mungesën e lirisë së lëvizjes dhe rrjedhimisht nuk po mund të jenë pjesë e mundësive të barabarta me të rinjt ndërkombetarë, si rezultat i kësaj ne po arrijmë të mbledhim në Prishtinë të rinjë nga vende të ndryshme dhe po u japim mundësi të rinjve tanë të jenë pjesëmarrës të aktiviteteve ndërkombetare dhe të punojnë në një mjedis diversiv duke përjashtuar të gjitha dallimet e mundshme!

OJQ "iCHAT", realizoi projektin, "Promovimi i Diversitetit Kulturor dhe Integrimi Social i Komuniteteve", i cili u mbështet nga Qeveria e Republikës së Kosovës-Zyra për Çështje të Komuniteteve. Synimi përfundimtar i projektit si dhe qëndrueshmëria e tij pas realizimit ishte zbutja dhe eliminimi i barrierave dhe paragjyqimeve ndërkulturore të të gjitha komuniteteve të cilat jetojnë në Kosovë. Njëherit u bë një barometër matës se divergjencat ndërkulturore mund të eliminohen edhe jashtë kornizave politike. Qëndrueshmëria e projektit konsistoi në nxitjen e vazhdueshme të aktiviteteve në përpjekje për t'i kontribuar të rinjve të Republikës së Kosovës. Përmes punës së përbashkët krijojuam një sistem të komunikimit të rregullt ndërmjet grupeve, dhe përmes avokimit synuam që ta rrisim vetëdijesimin e shoqërisë për rëndësinë e saj duke e bërë këtë program afatgjatë edhe në të ardhmen.

Zakonisht, aktivitet, gjetjet dhe rekomandimet, tryezat e rumbullakëta, diskutimet publike, të dhënat e shpërndara në hapësira publike, u mbuluan nga mediet. Ndërsa materialet e tjera për marrëdhënie me publikun, publikohen përmes teknologjive të komunikimit si: web faqe [www.ichat-rks.org](http://www.ichat-rks.org) faqja në Facebook dhe llogari të tjera.

## 2. POLITIKAT KONTABËL

### 2.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe raportimit financiar të zbatueshme në Republikën e Kosovës dhe në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 04/L-57 që aktualisht janë në fuqi në Republikën e Kosovës si dhe mbi bazën e kontabilitetit të përcaktuar në marrëveshjen me donatorët duke përfshi ketu edhe buxhetimin. Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike dhe parimit të moderuar të kontabilitetit, ku të hyrat njihen në momentin e inkasimit e jo kur ato janë fituar si dhe shpenzimet njihen kur ato ndodhin e jo kur ato paguhen.

### 2.2 Sistemi i kontabilitetit

Organizata përdor sistemin e kontabilitetit të zhvilluar në "Excel", i cili prodhon raporte të mjaftueshme financiare siç janë; libri i arkës, libri i bankës, librin kryesor, raportet e të hyrave dhe shpenzimeve për projekte si dhe pasqyrat financiare të OJQ-së si tërësi.

### 2.3 Valuta raportuese dhe prezantimi

Pasqyrat financiare janë përgatitur dhe prezantuar në valutën EURO, e cila njëherit është valuta funksionale dhe legale në Republikën e Kosovës.

### 2.4 Vijimësia

Pasqyra e pozicionit financiar dhe pasqyra e të ardhurave janë përgatitur mbi bazën e vijimësisë, sipas së cilës shoqëria do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë dhe detyrimet e saja në rrjedhën normale të biznesit.



## 2.5 Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë e parasë dhe ekuivalentëve të sajë, llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme janë përafërsisht të barabartë me vlerën e tyre, për shkak të likuiditetit dhe maturimit afatshkurtër të tyre.

## 2.6 Punonjësit dhe përfitimet

Përgjatë kohës së auditimit të gjithë të punësuarit nga OJQ "ICHAT" kishin kontrata të rregullta dhe valide bazuar në rregulloret dhe politikat e brendshme të Organizatës dhe në pajtueshmëri me ligjin e punës në Republikën e Kosovës. OJQ kontribuon vetëm me kontribute për sigurime sociale të detyrueshme që përcaktojnë përfitime pensionale për punëtorët pas pensionimit.

## 2.7 Të ardhurat dhe shpenzimet

Të hyrat nga grantet dhe donacionet si e hyrë në momentin e inkasimit të tyre, ndërsa të hyrat nga aktivitete ekonomike njihen kur shërbimet janë kryer apo mallrat janë dorëzuar dhe është bartur pronësia. Shpenzimet operative dhe shpenzimet tjera njihen në bazë akruale që d.m.th atëherë kur ato ndodhin. Shumat e të hyrave të pranuar prezantojnë kontributin financiar të aprovuar nga donatorët për të mbështetur shpenzimet e zhvillimit të projekteve dhe mbarrëvajtjes së operacioneve.

## 2.8 Tatimi mbi të ardhurat

Shoqëria është organizatë jo-profitabile dhe nuk shpërndanë fitim, kështu që sipas legjislacionit në fuqi nuk është subjekt i tatimit në të ardhura.



## SHËNIME SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE

## 3. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË

Paraja dhe ekuivalentët e parasë pasqyrojnë paratë në bankë dhe arkë, më 31 Dhjetor 2018 përbëhet nga si më poshtë:

<u>Paraja dhe ekuivalentët e parasë</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Arka	-	-
<b>Gjithsej paraja e imët</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
Banka-PCB -1117008880010135	-	131,055.64
Banka-PCB -1117008880000144	14,980.10	2.29
<b>Gjithsej paraja në bankë</b>	<b>14,980.10</b>	<b>131,057.93</b>
<b>Gjithsej paraja</b>	<b>14,980.10</b>	<b>131,057.93</b>

## 4. PRONA NDËRTESAT DHE PAJISJET

Shuma prej 847.87 Euro paraqet vlerën neto të cilat përbëhen nga inventari i zyrës së organizatës, më 31 Dhjetor 2018 përbëhet nga si më poshtë:

<u>Pajisjet dhe inventari për zyre</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Kompjuter	640.00	800.00
Tavolina	187.20	234.00
Karriga	232.64	290.80
Zhvlerësimi i vitit (20%)	(211.97)	(264.96)
<b>Gjithsej</b>	<b>847.87</b>	<b>1,059.84</b>

## 5. FONDET

Më 31 Dhjetor 2018 prezantojnë fondet e bartura dhe rritjen apo zvogëlimin e fondeve të periudhës dhe përbëhen nga si më poshtë:

<u>Fondet</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Net rritje/pakësim të fondeve nga periudhat e kaluara	132,117.77	1,324.80
Net rritje/pakësim të fondeve nga periudha vijuese	(116,289.80)	130,792.97
<b>Gjithsej fondet e bartura</b>	<b>15,827.97</b>	<b>132,117.77</b>

## 6. TË ARDHURAT

Të ardhurat prezantojnë të hyrat nga grantet, donacionet dhe aktivitet ekonomike të cilat më datë më 31 Dhjetor 2018 përbëhen si më poshtë:

<u>Të ardhurat</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Donacion GLZ	30,814.00	136,580.00
MKRS	3,980.00	1,990.00
KIMUN	100.00	850.00
MKRS-OSCE	1,230.00	1,079.92
MKK	15,000.00	-
MASHT	-	2,020.15
ATRC	-	13,147.64
<b>Të hyrat nga donacionet</b>	<b>51,124.00</b>	<b>155,667.71</b>
Të hyra nga antarësia	-	-
Të hyra tjera	-	3,509.09
<b>Të hyrat tjera</b>	<b>-</b>	<b>3,509.09</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>51,124.00</b>	<b>159,176.80</b>

## 7. SHPENZIMET PROGRAMORE

Shpenzimet programore prezantojnë shpenzimet e lidhura drejtpërdrejt në zhvillimin dhe kryerjen aktiviteteve programore përgjatë periudhës 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2018 të cilat përbëhen nga si më poshtë:

<u>Shpenzimet programore</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Paga neto	99,586.20	13,316.97
Kontributi pensional	10,259.55	691.25
Tatimi i mbajtur ne burim dhe kontributet pensionale	12,604.47	1,556.48
Shpenzimet e aktiviteteve programore	32,211.84	11,548.96
Shpenzimet tjera	-	-
<b>Gjithsej</b>	<b>154,662.06</b>	<b>27,113.66</b>

## 8. SHPENZIMET E ADMINISTRATËS DHE MENAXHMENTIT

Shpenzimet e administrates dhe menaxhmentit prezantojnë shpenzimet indirekte për mbështetjen e mbarrëvajtjes së aktiviteteve programore përgjatë periudhës 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2018 të cilat përbëhen nga si më poshtë:

<u>Shpenzimet e menaxhimit dhe administrates</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
Shpenzimet e qirase	7,200.00	740.25
Shpenzimet e zyres	1,404.10	-
Shpenzimet e komunikimit	195.80	-
Shpenzimet bankare	527.90	-
Shpenzime tjera	3,211.97	264.96
<b>Gjithsej</b>	<b>12,539.77</b>	<b>1,005.21</b>

## 9. NGJARJET PAS DATËS

Menaxhmenti i OJQ-së është përgjegjës për të shpalosur ngjarjet që mundë të kenë ndikim në pasqyrat financiare, deri në ditën e perpilimit të këtijë raporti, ne nuk kemi marrë nga menaxhmenti i OJQ-së ndonje rast apo ngjarje që mundë të ketë ndikim të mëvonshëme pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar dhe që kërkojnë rregullime në pasqyrat financiare ose shpalosje.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit.

Ne gjithashtu:

- *Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformatuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.*
- *Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.*
- *Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arësyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.*
- *Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.*

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.



*Raportet financiare sipas kërkesave ligjore mbi raportimin e OJQ-ve me status të përfituesit publik.*

**Bilanci i gjendjes**

"iCHAT" - Prishtinë

Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2018

<b>AKTIVA</b>	<b>Euro</b>	<b>PASIVA</b>	<b>Euro</b>
Para të gatshme	14,980.10	Llogaritë e pagueshme	-
Llogaritë e arkëtueshme		Detyrimet ndaj granteve	
Llogaritë tjera të arkëtueshme		Të hyrat e paftuara	
Stoqet		Hipoteka dhe detyrimet ndaj letrave me vlerë	
Parapagimet e shpenzimeve		Detyrimet tjera	-
Investimet:		<b>Gjithsej detyrimet:</b>	-
Letrat me vlerë			
Toka, ndërtesat, pajisjet në përgatitje		Fondi i OJQ-së:	15,827.97
Kredita e dhëna(konsumatorëve)		Fondi i bartur me 01.01. 2018	132,117.77
Toka, ndërtesat, dhe pajisjet	847.87	Të hyrat neto (Shih P/A)	(116,289.80)
Pasuritë tjera		Gjithsej fondë:	15,827.97
<b>Gjithsej pasuria:</b>	<b>15,827.97</b>	<b>Gjithsej detyrimet dhe kapitali</b>	<b>15,827.97</b>

**Pasqyra e të Ardhurave**  
**"iCHAT" - Prishtinë**  
 Për periudhën 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2018

<b>TË HYRAT</b>	<b>Euro</b>	<b>SHPENZIMET</b>	<b>Euro</b>
Të hyrat nga kontributet, dhuratat, apo grantet	<b>51,124.00</b>	Shpenzimet programore	<b>154,662.06</b>
Të hyrat nga aktivitetet ekonomike		Shpenzimet e menaxhimit dhe administratës	12,539.77
Të hyrat nga borxhet e këqija		Shpenzimet tjera	211.97
Të hyra nga interesi dhe dividendë		<b>Gjithsej shpenzimet:</b>	167,413.80
Të hyra nga qiraja		<b>Të hyrat neto nga operacionet:</b>	(116,289.80)
Të hyra tjera			
Fitimi nga shitja e pasurisë			
(humbja nga shitja e pasurisë)		Shpenzimet e tatimit	
Të hyra tjera të veçanta			
Të hyra nga shitja e mallit			
(Kosto e mallit të shitur)			
Të hyra tjera			
<b>Gjithsej të hyrat:</b>	<b>51,124.00</b>	<b>Të hyrat neto:</b>	<b>(116,289.80)</b>